


Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT me nr. Fiskal 603383324, në mbështetje të nenit 17, paragrafi 5, nënparagrafi 5.3 të LIGJIT NR. 08/L – 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, dhe në mbështetje të nenit 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUdhËN E PËRKOHSHME, i miratuar më datën 31.12.2024, me nr. Të protokollit 8648/24, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 07.10.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Miratohet raporti i përzgjedhjes së ofruesit i Komisionit Vlerësues për hartimin e Rregullores për mënyrën e punës dhe funksionimit të Kuvendit të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës. Oferta e përzgjedhur e cila është më e favorshme ekonomikisht është ajo e ofruesit z. Rinor Hoxha, me vlerë 1,000.00 (njëmijë) euro.
2. Miratohet raporti i përzgjedhjes së ofruesit i Komisionit Vlerësues për rishikimin dhe plotësimin e Projekt-Rregullores për organizimin e brendshëm të Administratës së Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës. Oferta e përzgjedhur e cila është më e favorshme ekonomikisht është ajo e ofruesit z. Rinor Hoxha, me vlerë 550.00 (pesëqind) euro.
3. Autorizohet Kryetari i OIRK-së, z. Arsim Rapuca, për nënshkrimin e kontratës me z. Rinor Hoxha për hartimin e këtyre dy dokumenteve.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit Mbikqyrës.
- Bordit Drejtues të OIRK-së
- Arkivit të OIRK-së.



Bordi Drejtues i OIRK-së:

1. **Arsim Rapuca**
Kryetar i OIRK-së
2. **Mimoza Shahini**
Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së
3. **Kadri Morina**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së
4. **Afrim Demiri**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së
5. **Nebi Pllana**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së
6. **Bujar Jupaj**
Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së
7. **Sami Kolgeci**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së



ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

RAPORT I PËRZGJEDHJES SË OFERTUESIT

Për hartimin e Rregullores për mënyrën e punës dhe funksionimit të Kuvendit të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës

1. Hyrje

Në bazë të vendimit të Bordit Drejtues të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK), është shpallur ftesa për oferta për angazhimin e një eksperti për hartimin e Rregullores për mënyrën e punës dhe funksionimit të Kuvendit të OIRK-së.

Qëllimi i këtij angazhimi është përgatitja e një dokumenti profesional dhe të harmonizuar me Ligjin Nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, Statutin e OIRK-së dhe aktet tjera nënligjore përkatëse.

2. Komisioni vlerësues

Komisioni për vlerësimin dhe përzgjedhjen e ofertave është përbërë nga:

Nr. Emri dhe mbiemri Pozita në Komision

- | | | |
|---|--------------|----------|
| 1 | Arsim Rapuca | Kryesues |
| 2 | Afrim Demiri | Anëtar |
| 3 | Bujar Jupaj | Anëtar |

Komisioni është mbledhur me datë 07/10/2025 për të shqyrtuar dhe vlerësuar ofertat e pranuar.

3. Ofertat e pranuar

Janë pranuar gjithsej tre (3) oferta për këtë shërbim profesional:

Nr.	Emri i ofertuesit	Përshkrimi i shërbimit	Çmimi i ofruar (€)
1	Rinor Hoxha	Hartimi i Rregullores për mënyrën e punës dhe funksionimit të Kuvendit të OIRK-së	1,000 €
2	Eris Hana	Hartimi dhe finalizimi i Rregullores së Kuvendit të OIRK-së	1,250 €
3	Korab Dibra	Hartimi dhe konsultimi i Rregullores së Kuvendit të OIRK-së	1,500 €



ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Të gjitha ofertat kanë përmbushur kriteret teknike dhe tematike të përcaktuara në ftesën për ofertë, ndërsa ndryshojnë në aspektin e ofertës financiare.

4. Vlerësimi dhe rekomandimi

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së ofertave, Komisioni ka konstatuar se të gjithë ofertuesit kanë paraqitur plane pune profesionale dhe në përputhje me kërkesat e Odës.

Megjithatë, oferta më e favorshme ekonomikisht është ajo e ofertuesit z. Rinor Hoxha, me vlerë 1,000 (njëmijë) euro, e cila përmbush të gjitha kriteret teknike dhe përmbajtësore të kërkuara, duke qenë njëkohësisht me çmimin më të ulët ndër ofertat e pranuar.



5. Përfundimi

Në bazë të vlerësimit profesional dhe analizës financiare, Komisioni rekomandon angazhimin e z. Rinor Hoxha për hartimin e *Rregullores për mënyrën e punës dhe funksionimit të Kuvendit të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës*, si ofertuesi me çmimin më të ulët dhe dokumentacion të plotë.

6. Vendimi i rekomanduar

Komisioni i propozon Bordit Drejtues të OIRK-së që të miratojë këtë rekomandim dhe të autorizojë Kryetarin e OIRK-së, z. Arsim Rapuca, për nënshkrimin e kontratës me z. Rinor Hoxha.

7. Nënshkrimet e Komisionit

Emri dhe mbiemri	Pozita	Nënshkrimi
Arsim Rapuca	Kryesues	
Afrim Demiri	Anëtar	
Bujar Jupaj	Anëtar	

Datë: 07/10/2025

Vendi: Prishtinë